



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 18 nëntor 2019

Z. Cengiz Kovaç

E-mail: cngzkvc@gmail.com

VENDIM

A. nr. 9/2019

Cengiz Kovaç
kundër

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 dhjetor 2018, ka pranuar ankesë nga z. Cengiz Kovaç, parashtruar kundër Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), lidhur me Udhëzimin Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna (në tekstin e mëtejme: UA nr. 2014/01).

Sipas pretendimeve të ankuesit, dispozitat e UA nr. 2014/01 nuk janë në harmoni me dispozitat kushtetuese, konkretisht me nenin 62 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe, si rezultat i kësaj, atyre po u mohohet e drejta e përfaqësimit, e garantuar me Kushtetutë.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit, pas analizimit të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe UA nr. 2014/01, më 31 korrik 2019, i ka dërguar Letër Rekomandim MAPL-së, duke i rekomanduar:

- *Ta bëjë ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht ta fshijë paragrafin 2 të nenit 6.*
- *Në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë veprime konkrete, me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht ta bëjnë harmonizimin gjuhësor të nenit 61, paragrafët 1 dhe 3.*
- *Të ndërmarrë masa konkrete me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, përkatësisht ta bëjë harmonizimin gjuhësor të nenit 4, paragrafët 1 dhe 3.*

Më 30 gusht 2019, MAPL-ja ka kthyer përgjigje dhe ka njoftuar se procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 2014/01 do të fillojnë këtë vit, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale do të vendoset në strategjinë legislative për vitin 2020.

Ndërkaq, më 4 tetor 2019, MAPL-ja e ka njoftuar Avokatin e Popullit se, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve në fjalë, më 11 shtator 2019, e ka nxjerrë Vendimin nr. 039-152/4, me të cilin e ka shfuqizuar UA nr. 2014/01.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në veprimet e MAPL-së, përkatësisht shfuqizimin e UA nr. 2014/01 dhe zotimit se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale do të vendoset në strategjinë legjislative për vitin 2020, vlerëson së çështja e ngritur nga ankuesi është adresuar dhe se ka marrë përgjigje pozitive. Sidoqoftë, Avokati i Popullit do t'i ndjekë zhvillimet që kanë të bëjnë me harmonizimin gjuhësor të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Duke u bazuar në rrethanat e theksuara më sipër, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 27 dhe sipas rrethanave të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka vendosur t'i përfundojë hetimet përkitazi me këtë çështje.



Hilmi Jashari
Avokat i Popullit